

# TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

## Përmbajtja

1. MATERIALE KËRKIMORE	1
2. AKTIVITETE KËRKIMORE	6
3. LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA	7

Materiali "Të Rejat shkencore në Bankën e Shqipërisë" paraqet një përmbledhje të punës kërkimore të Bankës së Shqipërisë në harkun kohor të gjashtë muajve. Ky numër pasqyron disa nga punët kërkimore të sapo përfunduara, punët kërkimore në proces, artikujt, si dhe aktivitetet kryesore kërkimore shkencore të zhvilluara nga ekonomistët e Bankës së Shqipërisë, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021.

## 1. MATERIALE KËRKIMORE

### 1.1 MATERIALE KËRKIMORE TË PËRFUNDUARA

Kërkimi shkencor në Bankën e Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe është orientuar drejt materialeve dhe analizave empirike me në fokus tema që kanë të bëjnë me kulturën financiare, kërkesën dhe ofertën bankare, rolin e parasë, teknologjitë financiare, zhvillimet demografike etj. Në mënyrë të përmbledhur ato paraqiten më poshtë.

#### **"Evidenca mbi kulturën financiare në Shqipëri" nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë**

Materiali paraqet evidenca mbi kulturën financiare në Shqipëri bazuar në të dhënat e Vrojtimit për Matjen e Kulturës Financiare të Popullatës të zhvilluar nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2019. Të dhënat tregojnë që niveli i kulturës financiare i individëve në Shqipëri është i ulët krahasuar me mesataren e individëve në botë. Individët në Shqipëri zotërojnë

vetëm 53% të totalit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve të duhura financiare, e cila reflektohet edhe në një nivel të ulët të përfshirjes financiare, si në terma të njohjes, ashtu edhe të përdorimit të produkteve dhe shërbimeve financiare. Vetëm 54% e individëve në Shqipëri njohin të paktën pesë produkte financiare, përkundrejt 83% të individëve në nivel global. Gjithashtu, individët në Shqipëri përdorin më shumë mjetet e pagesës, por niveli i përdorimit të tyre është pothuajse 2.5 herë më i ulët se niveli global i përdorimit të tyre. Bazuar në karakteristikat socio-ekonomike të individëve, kemi identifikuar që individët me nivel më të ulët të kulturës financiare në Shqipëri janë: femrat, individët e grupmoshës 18-29 vjeç dhe 60-79 vjeç, individët pa ose me edukim minimal, të papunët, shtëpiakët, individët të paafte për punë, studentët dhe individët me nivel të ulët të ardhurash. Rrjedhimisht këto grupe, por jo vetëm, duhet të përfshihen në programet e strategjisë së edukimit financiar, për të

pasur në të ardhmen një rritje të kulturës dhe mirëqenies financiare të gjithë individëve në tërësi.

***“Përdorimi i qasjes së modelit empirik për parashikimin e nevojës afatshkurtër dhe asaj afatgjatë për likuiditet në tregun ndër bankar, në rastin e sektorit financiar shqiptar”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve***

Banka e Shqipërisë rregullon nevojën për likuiditet në sektorin financiar në një horizont kohor të zgjedhur, për të pasqyruar qëndrimin e saj të politikës monetare. Është ky këndvështrim që banka qendrore analizon për të parashikuar kërkesën për likuiditet afatshkurtër dhe afatgjatë në treg, i cili ndryshon si rezultat i ndryshimeve të faktorëve autonomë dhe atyre jo autonomë. Për këtë arsye, ky punim zhvillon një sërë modelesh empirike me të dhëna ditore për periudhën 2008–2019, me qëllim parashikimin e nevojës për likuiditet në tregun ndërbankar, duke u mbështetur në tregues binar dhe në përqasjen e ndarjes së likuiditetit sipas faktorëve autonomë dhe atyre diskrecionarë.

## **1.2 MATERIALE KËRKIMORE NË PROCES**

***“Kërkesa dhe oferta në tregun e huasë bankare: A ka përjetuar Shqipëria një episod të krizës (disekuilibri) pas krizës financiare globale?”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve***

Ky punim paraqet një analizë empirike të hipotezës të ekzistencës së një episodi të mundshëm krize (racionimi) në tregun e kredisë në Shqipëri, duke u përqendruar veçanërisht në periudhën pas krizës financiare globale. Duke përdorur të dhëna makroekonomike dhe ato nga sektori bankar

gjatë kësaj periudhe, ne veçojmë kërkesën dhe ofertën e kredisë, duke vlerësuar një model dinamik të disekuilibrit të tregut shqiptar të huasë bankare sipas qasjes standarde VAR. Analiza përfshin tregun e huasë bankare ndaj firmave dhe familjeve. Rezultatet kryqëzohen me të dhënat e Vrojtimit të Aktivitetit Kredites.

***“A luan rol paraaja në vlerësimin e politikës monetare në Shqipëri?”, nga Altin Tanku, Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve***

Banka e Shqipërisë i dha një rol të rëndësishëm parasë deri në mesin e dekadës së parë të viteve 2000. Në vijim të një tranzicioni të butë drejt një regjimi të plotë të shënjestrimit të inflacionit, norma e interesit mori rolin e instrumentit qendror për transmetimin e politikës monetare. Ky kurs drejtimi ishte në të njëjtën linjë me qasjen e gjithë pranuar në atë kohë, sipas së cilës sasia e parasë nuk siguron informacion mbi përcaktimin e niveleve të prodhimit, çmimeve dhe normave të interesit. Sidoqoftë, goditjet negative të shkaktuara nga kriza financiare globale dhe më pas nga pandemia COVID-19 provokuan një ndryshim thelbësor në kursin e politikës monetare, për të vënë theksin në zgjerimin e bilancit të bankës qendrore. Zgjerimi monetar është kthyer tashmë në instrumentin parësor të politikës monetare. Qëllimi i këtij artikulli është të vlerësojë vlefshmërinë empirike të kësaj “qasjeje të re” për një ekonomi të vogël në zhvillim, duke përdorur një model VAR, me qëllim studimin e efekteve të goditjeve të parasë mbi treguesit ekonomikë të Shqipërisë. Në mënyrë që ta realizojmë siç duhet këtë, synojmë së pari të përcaktojmë dhe ndërtojmë treguesin e saktë të goditjes së parasë dhe ta identifikojmë atë qartësisht në bilancin e Bankës së Shqipërisë.

***“Fintek 2020: Politikat rregullatore, monedhat elektronike dhe “stablecoins””, nga Bledar Hoda, Departamenti i Kërkimeve***

Cikli i risive në teknologjinë financiare (më tej FinTek) vazhdon të mbetet një proces ende në zgjerim, ndërsa përhapja e produkteve dhe shërbimeve FinTek në industrinë financiare po merr përmasa globale. Në sektorin privat, këto risi po evoluojnë në formën e (i) zhvillimeve në përjasjen rregullatore të autoriteteve ndaj FinTek dhe industrisë financiare; dhe (ii) zhvillimeve në tregun e kriptomonedhave dhe monedhave të reja “StableCoins” të kolateralizuara. Në sektorin publik, risitë teknologjike po evoluojnë në formën e (iii) vëmendjes nga një numër në rritje i bankave qendrore ndaj potencialit të Parasë Elektronike të Bankave Qendrore (më tej PEBQ) ose eksperimentimit laboratorik të tyre<sup>1</sup>. Në këtë material synohet një përmbledhje e shkurtër e zhvillimeve në këto tre aspekte të FinTek. Konstatohet se përjasja rregullatore e ndërmarrë në vende të ndryshme nuk është aspak uniforme. Përjasjet dallojnë në varësi të aktivitetit FinTek që po merr hov në secilën ekonomi dhe në varësi të hapjes që çdo vend ka ndaj këtyre aktiviteteve.

***“Vlerësimi i efekteve të ndryshimeve demografike në ekonominë shqiptare”, nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve***

Në kuadër të ndryshimeve të shpejta demografike që kanë karakterizuar popullsinë shqiptare përgjatë viteve të fundit dhe që priten të vijojnë edhe në vitet e ardhshme, të tilla si: plakja dhe emigrimi i fuqisë punëtore (kryesisht i të rinjve dhe të arsimuarve), ky projekt synon të

<sup>1</sup> Paraja Elektronike e Bankave Qendrore (PEBQ) është një përshtatje e termit në gjuhën angleze “Central Bank Digital Currency (CBDC)”.

analizojë dhe vlerësojë efektet ekonomike dhe financiare të këtyre zhvillimeve në ekonominë shqiptare, të cilat nuk mund të vlerësohen përmes modeleve tradicionale ekonometrike, si dhe të propozohen më tej politikat e duhura ekonomike në përgjigje të tyre.

***“Vrojtimi për matjen e kulturës financiare: Analiza e rezultateve për Shqipërinë, 2019”, nga Arlinda Koleniço, Kliti Ceca dhe Egnis Isaku, Departamenti i Kërkimeve***

Banka e Shqipërisë ka kryer për herë të tretë mbledhjen dhe publikimin e të dhënave që lidhen me nivelin e kulturës financiare të popullatës në Shqipëri. Anketa “Kultura Financiare në Shqipëri” bazohet në direktivat dhe metodologjinë e OECD/ INFE dhe u realizua në bashkëpunim me INSTAT-in në muajt shtator-tetor 2019. Të dhënat e marra nga kjo anketë përbëjnë një informacion të rëndësishëm për identifikimin e çështjeve që kanë nevojë për vëmendje dhe ndërhyrje, përmes projekteve të edukimit financiar nga ana e Bankës së Shqipërisë.

### 1.3 ARTIKUJ KËRKIMORË

***“Një vështrim statistikor dhe empirik mbi flukset e remitancave”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve***

Flukset e remitancave përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash për financimin e kërkesës agregate. Ato janë gjithashtu një zë i rëndësishëm në statistikën e bilancit të pagesave të Shqipërisë. Për këtë arsye, ky material analizon një sërë çështjesh të rëndësishme të lidhura me qëndrueshmërinë e tyre, persistencën e goditjes dhe shpejtësinë së kthimit në ekuilibër, në rast të një goditjeje ekonomike. Një pjesë e rëndësishme zë edhe analizimi i marrëdhënies afatgjatë, nëse ekziston, midis flukseve të remitancave

dhe treguesve makroekonomikë të lidhur me vendet dërguese dhe ato pranuese. Studimi fokusohet në periudhën pas krizës financiare globale.

***“Remitancat dhe ndikimi i tyre në varfëri: rasti i Shqipërisë”, nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve dhe Argita Frashëri, Departamenti i Statistikave Financiare***

Qëllimi i këtij artikulli është të vlerësojë ndikimin që kanë remitancat në varfërinë në Shqipëri, bazuar në të dhënat individuale të familjeve marrë nga vala e parë e Anketës së Pasurisë së Familjeve në Shqipëri, zhvilluar nga Banka e Shqipërisë në vitin 2019. Të dhënat e vrojtimit tregojnë se në vitin 2018, 23% e familjeve shqiptare kanë marrë të ardhura nga emigrantët, mesatarisht 2,000 euro për familje në vit, shumë e cila ndryshon në varësi të grupeve të ndryshme të familjeve dhe rajonit. Për më tepër vlerësohet se remitancat janë burimi i dytë më i rëndësishëm i të ardhurave të familjeve, pas të ardhurave nga puna. Vlerësimet empirike të bazuara në regresionet probit tregojnë se remitancat kanë një ndikim pozitiv në uljen e probabilitetit të familjeve për të qenë të varfra, duke konfirmuar rëndësinë e tyre për familjet shqiptare.

***“Ndikimi në papunësi i një goditjeje të ardhur nga kriza ekonomike”, nga Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve***

Pandemia COVID-19 krijoi një turrje të paprecedentë të ecurisë së shumicës së treguesve ekonomikë në të gjithë botën. Si rezultat i kësaj krize socio-ekonomike, prodhimi i brendshëm bruto i Shqipërisë pësoi një goditje të thellë negative. Kjo analizë kërkimore adreson lidhjen midis shkallës së papunësisë dhe rritjes ekonomike, në kushtet kur kjo e fundit pëson rënie drastike të menjëhershme, si në rastin e

asaj të shkaktuar nga pandemia COVID-19. Modeli ekonometrik i përdorur për shkallën e papunësisë në Shqipëri përdor flukset neto të tregut të punës, të vlerësuara nga të dhënat e ofruara zyrtarisht mbi tregun e punës. Ky model është një specifikim VAR i përdorur për të përshkruar përgjigjet e shkallës së papunësisë ndaj çdo goditjeje të simuluar ndaj secilës prej flukseve neto të tregut të punës, si dhe serisë së rritjes ekonomike. Gjetjet e analizës mbështeten në funksionet e reagimit të impulseve (impulse-response) të VAR. Rezultatet tregojnë që për një rënie të aktivitetit ekonomik prej 10 pikë përqindjeje brenda një tremujori të vetëm, ndryshimi vjetor i shkallës së papunësisë rritet me rreth 1.84 pikë përqindjeje përgjatë 4 tremujorëve pasues.

***“Akumulimi i aktiveve dhe borxhit të familjeve në vendet pritëse të remitancave: Evidenca nga Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare”, nga Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve***

Duke përdorur të dhënat e valës së parë të Anketës së Pasurisë së Familjeve Shqiptare (2019), ky material ka për qëllim analizimin e diferencave në akumulimin e pasurisë neto të familjeve, si dhe analizimin e pabarazisë e pasurisë dhe ndikimin e të ardhurave nga emigrantët në të. Analiza sugjeron se familjet të cilat marrin remitanca janë më vulnerabël ndaj goditjeve ekonomike sesa ato që nuk marrin remitanca. Për rrjedhojë, remitancat kanë një potencial të lartë të kontribuojnë pozitivisht në nivelin e varfërisë dhe mirëqenies së tyre. Familjet që marrin remitanca kanë një normë pjesëmarrjeje më të lartë në aktivet reale e veçanërisht në zotërimin e banesës kryesore dhe pasurive të tjera të patundshme sesa familjet të cilat nuk marrin remitanca, por mesatarisht zotërojnë një vlerë më të ulët në terma monetarë në formën e këtyre aktiveve. Rezultatet

tregojnë që koeficienti Gini i pasurisë neto për familjet të cilat marrin remitanca është më i ulët e për rrjedhojë, remitancat duket se kontribuojnë pozitivisht në shpërndarjen totale të pasurisë.

#### 1.4. ARTIKUJ KËRKIMORË NGA BANKA TË TJERA QENDRORE

##### ***“Pasiguria globale”, Giovanni Caggiano, Efrem Castelnovo, Banka e Finlandës***

Autorët paraqesim vlerësimin e një njehsuesi të ri të pasigurisë financiare globale (GFU) nëpërmjet një sistemi faktorësh dinamikë, i cili modelon së bashku faktorët globalë, rajonalë dhe specifikë për shtetet. Autorët identifikojmë sasinë e ndikimit të goditjeve nga GFU në prodhimin global nëpërmjet një analize VAR që mundëson vetëidentifikim me anë të një kombinimi kufizimesh për narrativat, shenjat, raportet dhe korrelacionet. Autorët përcaktojmë se humbja e prodhimit global që u vu re gjatë recesionit të madh do të kish qenë 13% më pak në kushtet e mungesës së goditjeve nga GFU. Gjithashtu autorët zbulojmë ekzistencën e një multiplikatori të pasigurisë financiare globale: sa më shumë përkeqësohen kushtet financiare globale aq më shumë tkurret prodhimi global.

[https://helda.helsinki.fi/bof/bitstream/handle/123456789/17884/BoF\\_DP\\_2101.pdf?sequence=1&isAllowed=y](https://helda.helsinki.fi/bof/bitstream/handle/123456789/17884/BoF_DP_2101.pdf?sequence=1&isAllowed=y)

##### ***“Rialokimi i Punës gjatë Pandemisë Covid-19”, Daniel Aaronson, Riley Lewers, Daniel G. Sullivan, Banka e Rezervës Federale e Çikagos***

Pandemia COVID-19 dhe recesioni shoqërues kanë pasur efekte dramatisht të ndryshme në gamën e industrive, ku sektori i shërbimeve dhe i turizmit u shkatërruan

plotësisht dhe shumica e industrisë përpunuese pati mundësi të rikuperohet mjaft shpejt. Kjo ka bërë që disa analistë të përshkruajnë pandeminë si një goditje ri-shpërndarjeje, që kërkon lëvizje të konsiderueshme të fuqisë punëtore nga një pjesë e industrive në tjetrën. Gjasat janë që një proces i tillë të kërkojë kohë të konsiderueshme, gjatë së cilës shkalla natyrore e papunësisë mund të rritet. Në këtë artikull të Çikago Fed, autorët marrim në konsideratë dy pyetje: së pari, a është rritur nevoja për ri-shpërndarje të punës; dhe së dyti, a ka pasur një rritje në sasinë e ri-shpërndarjes që po ndodh aktualisht?

<https://www.chicagofed.org/publications/chicago-fed-letter/2021/45>

##### ***“Sjellja e bankave gjermane në një mjedis me normë të ulët interesi”, Ramona Busch, Helge C. N. Littke, Christoph Memmel, Simon Niederauer, Banka e Gjermanisë***

Duke përdorur të dhëna nga një sondazh sasior i bankave gjermane në tri periudha në kohë (2015, 2017 dhe 2019), autorët marrim në analizë ndikimin e ndryshimeve në nivelin e normës së interesit për të ardhurat neto të interesit bankar dhe kundërmarrat e ndërmarra nga bankat. Një rënie në nivelin e normës së interesit ka një ndikim më negativ në të ardhurat neto nga interesi, dhe sa më e gjatë në kohë rezulton rënia, aq më shumë ulet niveli i normës së interesit. Ky ndikim zbutet me rritjen e rrezikut të ndryshimeve në vlerën aktuale të llogarive bankare. Autorët nuk gjejnë se bankat kanë tendencë të rrisin nivelet e rrezikut nëse vënë re rënie në të ardhurat e tyre. Sidoqoftë, bankat me kapital të dobët pas një periudhe kohore e rrisin rrezikun e portofolit të tyre të bonove. Pas një rënieje në të ardhurat operacionale, bankat i rrisin të ardhurat nga tarifat dhe komisionet dhe i ulin kostot e tyre. Për më tepër rezultojnë që

pas një rënies në të ardhurat nga interesi, bankat kanë tendencën të zgjasin afatet e huadhëniesve hipotekare.

<https://www.bundesbank.de/resource/blob/869794/>

## 2. AKTIVITETE KËRKIMORE

### 2.1 SEMINARE TEKNIKE

**Prezantimi me temë “ Historia Ekonomike e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, nga viti 1800 deri më sot” nga Dr. Matthias Morys, lektor i Ekonomiksit në Universitetin e York-ut, shkurt 2021**

Prezantimi bën një përmbledhje të librit me të njëjtin titull të përgatitur nga autori, i cili paraqet historinë ekonomike të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, nga viti 1800 deri në ditët e sotme. Kështu, tre dekada pas rënies së komunizmit në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, në shumë vende, procesi i transformimit është i paplotë, duke bërë që procesi i konvergimit të jetë më i gjatë se sa pritej. Situata aktuale në Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore ka nxjerrë në pah nevojën për një kuptim më të mirë të implikimeve politike dhe ekonomike afatgjata të përvojës historike të këtij rajoni. Duke sjellë së bashku autorë nga lindja dhe perëndimi, libri gjithashtu mbështet në kërkimin shkencor të një brezi të ri studiuesish nga rajoni, duke bërë një pasqyrim plotësisht modern të historisë së tij.

### 2.2 AKTIVITETE TË TJERA

**Banka e Shqipërisë bëhet pjesë e Rrjetit për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (Network for Greening the Financial System, NGFS)**

Që prej fillimit të vitit 2021, Banka e Shqipërisë është bërë anëtare e Rrjetit për Gjelbërimin e Sistemit Financiar (NGFS). Qëllimi i këtij rrjeti është të ndihmojë në forcimin e përgjigjes globale, me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuar nga Marrëveshja e Parisit, për të rritur rolin e sistemit financiar në menaxhimin e rreziqeve dhe për të mobilizuar kapitalin drejt investimeve të gjelbra dhe me karbon të ulët, në kontekstin më të gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor. Për këtë qëllim, Rrjeti (NGFS) përcakton dhe promovon praktikat më të mira për t’u zbatuar brenda dhe jashtë anëtarëve të NGFS-së, si dhe kryen punë analitike mbi financat e gjelbra.

**“Aktivitete trajnuese të stafit të Departamentit të Kërkimeve në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës Qendrore të Austrisë dhe Bankës së Shqipërisë”, online, Banka e Shqipërisë**

Në kuadër të bashkëpunimit midis Bankës Qendrore të Austrisë dhe Bankës së Shqipërisë, janë zhvilluar katër seminare, qëllimi i të cilave ishte prezantimi i Vrojtim

të Euros, si dhe përdorimi i këtyre të dhënave në punën kërkimore, analizuese dhe vendimmarrëse në Bankën Qendrore të Austrisë. Më poshtë gjeni listën e temave të prezantuara:

- “Zgjatja dhe përcaktuesit e euroizimit - Dëshmi nga Vrojtimi i Euros i Bankës Qendrore së Austrisë”, nga Thomas Scheiber, Departamenti i Kërkimeve, Banka qendrore e Austrisë;
- “Kursimet e familjeve para krizës COVID-19”, nga Melanie Koch, Departamenti i Kërkimeve, Banka

Qendrore e Austrisë;

- “Treguesit e ndjeshmërisë makroprudenciale bazuar në Vrojtimin e Euros të Bankës Qendrore të Austrisë”, nga Aleksandra Riedl, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Qendrore e Austrisë;
- “Përfaqja metodologjike e Vrojtimin të Euros të Bankës Qendrore të Austrisë”, nga Elisabeth Beckmann, Departamenti i Kërkimeve, Banka Qendrore e Austrisë.

### 3.LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA:

#### **Banca d'Italia**

(<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>)

#### **Bank of Canada**

<http://www.bankofcanada.ca/research/>

#### **Banco de Espana**

(<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

#### **Bank of England**

(<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>)

#### **Bank of Finland**

(<http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit/julkaisut/index.htm>)

#### **Bank of Greece**

(<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

#### **BIS Central Bank Research Hub**

(<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

#### **Czech National Bank**

(<http://www.cnb.cz/en/research/>)

#### **Deutsche Bundesbank**

([http://www.bundesbank.de/vfz/vfz\\_diskussionspapiere\\_2009.en.php](http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php))

#### **European Central Bank**

(<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

#### **Federal Reserve**

(<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

#### **International Journal of Central Banking**

(<http://www.ijcb.org/>)

#### **National Bureau of Economic Research**

(<http://www.nber.org/>)

#### **International Monetary Fund**

(<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)

#### **Oesterreichische Nationalbank**

([http://www.oenb.at/en/presse\\_pub/research/research.jsp](http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp))